



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA SKRAPAR

### RELACION

#### **“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ, NË ZBATIM TË VKM-së Nr.503, DATË 1.08.2024“**

Të nderuar Këshilltar!

Grupi Menaxhimit Strategjik në mbështetje, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH”, neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9936, dt.26.06.2008”, i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024” , VKM-së nr.503, date 01.08.2024 “Për disa ndryshime në VKM-në nr.328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, ka paraqitur për miratim nivelin e pagave sipas përcaktimeve në VKM-në e mësipërme.

Rritja e nivelit të pagave detyrues shtesë në buxhetin e Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë. Për muajin shtator tetor dhe netor, të vitit buxhetor 2024 nga përlllogaritjet e bëra, nevojat për fonde buxhetore shtesë janë në vlerën prej 12,995,565 lekë, nga të cilat për paga janë në vlerën prej 11,154,991 lekë dhe për sigurime shoqërore në vlerën prej 1,840,573 lekë.

Me shkresën nr.11788 datë 04.09.2024 Ministria e Financave ka akorduar fonde shtesë për rritjen e nivelit të pagave, sipas kufirit minimal në vlerën prej 8,516,007 lekë.

Diferenca prej 4,479,558 lekë u kompesua me transferimet e buxhetit të miratuara me VKB-në Nr.40, date 26.08.2024, konfirmuar te Prefekti Qarkut Berat me shkresën nr.607/1 datë 27.08.2024. **Theksojmë se ky nivel pagash do të jetë vetëm për muajit shtator tetor dhe nëntor të vitit 2024, ndërsa niveli pagave për vitin 2025 do të rishikohet në varësi të nivelit të transfertave që do të akordohen nga Ministria e Fincave për vitin 2025.**

Ju faleminderit

